



Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare

Strasbourg, me 5.11.1992

Preambula

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkruese të këtij dokumenti,

Duke pasur parasysh që qëllimi i Këshillit të Evropës është arritja e një uniteti më të madh midis anëtarëve të tij, veçanërisht me qëllim të mbrojtjes dhe të realizimit të idealeve dhe të parimeve që janë trashëgimia e tyre e përbashkët;

Duke pasur parasysh që mbrojtja e gjuhëve historike rajonale ose të pakicës në Evropë, disa prej të cilave janë në rrezik të zhdukjes së mundshme, kontribuon në ruajtjen dhe në zhvillimin e pasurisë dhe të traditave kulturore të Evropës;

Duke pasur parasysh se e drejta për përdorimin e gjuhës rajonale ose të pakicës në jetën private dhe atë publike është e drejtë e patjetërsueshme, në pajtim me parimet e mishëruara në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike të Kombeve të Bashkuara, dhe në përputhje me frymën e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore të Këshillit të Evropës;

Duke iu referuar punës së kryer në kuadër të KSBE-së dhe në veçanti Aktit Përfundimtar të Helsinkit të vitit 1975 dhe dokumentit të Takimit të Kopenhagës të vitit 1990;

Duke e theksuar vlerën e konceptit ndërkulturor dhe shumëgjuhësor dhe duke e pasur parasysh që mbrojtja dhe inkurajimi i gjuhëve rajonale dhe të pakicës nuk duhet të jetë në dëm të gjuhëve zyrtare dhe të nevojës për t'i mësuar ato;

Duke e kuptuar që mbrojtja dhe nxitja e gjuhëve rajonale dhe të pakicës në vende dhe rajone të ndryshme të Evropës paraqet një kontribut të rëndësishëm për krijimin e një Evrope të bazuar në parimet e demokracisë dhe të llojllojshmërisë kulturore brenda kornizës së sovranitetit kombëtar dhe të integritetit territorial;

Duke i marrë parasysh kushtet specifike dhe traditat historike në rajonet e ndryshme të shteteve evropiane,

Janë pajtuar si më poshtë:

Pjesa I – Dispozitat e përgjithshme

Neni 1 – Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Karte:

- a. "gjuhë rajonale ose e pakicës " nënkupton gjuhët që janë:
 - i. përdorë në mënyrë tradicionale brenda një territori të caktuar të një shteti nga shtetasit e atij shteti, të cilët e formojnë një grup numerikisht më të vogël se pjesa tjetër e popullsisë së shtetit; dhe
 - ii. të ndryshme nga gjuha (gjuhët) zyrtare të atij shteti;
nuk i përfshinë as dialektet e gjuhës (gjuhëve) zyrtare të shtetit dhe as gjuhët e shtegtarëve;
- b. "territori në të cilin përdoret gjuha rajonale apo e pakicës " nënkupton zonën gjeografike në të cilën gjuha në fjalë është mënyra e shprehjes së një numri të njerëzve, që justifikon marrjen e masave të ndryshme mbrojtëse dhe mbështetëse të parashikuara në këtë Kartë;
- c. "gjuhët jo-territoriale" nënkupton gjuhët e përdorura nga shtetasit e shtetit, të cilat ndryshojnë nga gjuha ose gjuhët e përdorura nga pjesa tjetër e popullsisë së shtetit, por që ndonëse të përdorura në mënyrë tradicionale brenda territorit të atij shteti nuk mund të identifikohen me një vend të caktuar.

Neni 2 – Angazhimet

1. Secila palë angazhohet t'i zbatojë dispozitat e Pjesës II për të gjitha gjuhët rajonale ose të pakicës, të cilat fliten brenda territorit të saj dhe të cilat janë në pajtueshmëri me përkufizimin në nenin 1.
2. Për çdo gjuhë të saktësuar në kohën e ratifikimit, të pranimit ose të miratimit, në përputhje me nenin 3, secila palë angazhohet të zbatojë një minimum prej tridhjetë e pesë paragrafëve ose nënparagrafëve të zgjedhur nga dispozitat e Pjesës III të Kartës, përfshirë së paku tre të zgjedhur prej nenit 8 dhe 12, dhe një prej nenit 9, 10, 11 dhe 13.

Neni 3 – Masat praktike

1. Secili shtet palë e saktëson në instrumentin e tij të ratifikimit, të pranimit ose të miratimit, çdo gjuhë rajonale ose të pakicës, ose gjuhën zyrtare që përdoret më pak në të gjitha pjesët e territorit të tij ose në një pjesë të territorit të tij, për të cilën vlejnë paragrafet e zgjedhura në pajtim me nenin 2, paragrafin 2.
2. Secila palë mund ta njoftojë në çdo kohë të mëvonshme Sekretarin e Përgjithshëm se i pranon detyrimet që dalin nga dispozitat e secilit paragraf tjetër të Kartës të cilat nuk janë saktësuar në instrumentin e saj të ratifikimit, të pranimit ose të miratimit, ose që do ta zbatojë paragrafin 1 të këtij neni për gjuhët rajonale ose të pakicës të cilat përdoren më pak në gjithë territorin e saj ose në një pjesë të territorit.
3. Masat e përmendura në paragrafin e mësipërm konsiderohen si pjesë përbërëse të ratifikimit, të pranimit ose të miratimit dhe do ta kenë fuqinë e njëjtë që nga data e njoftimit.

Neni 4 – Regjimet ekzistuese të mbrojtjes

1. Asgjë në këtë Kartë nuk interpretohet si kufizim ose shmangie nga ndonjë e drejtë e garantuar me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
2. Dispozitat e kësaj Karte nuk ndikojnë në asnjë dispozitë më të favorshme që ka të bëjë me gjendjen e gjuhëve rajonale dhe të pakicës, ose në regjimin juridik të personave që ju përkasin pakicave të cilat mund të ekzistojnë në një palë ose të cilat janë parashikuar në marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare dypalëshe apo shumëpalëshe.

Neni 5 – Detyrimet ekzistuese

Asgjë në këtë Kartë nuk mund të interpretohet si nënkuptim i ndonjë të drejte për t'u angazhuar në ndonjë aktivitet ose për të kryer ndonjë veprim që është në kundërshtim me qëllimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara ose me detyrimet e tjera sipas së drejtës ndërkombëtare, përfshirë parimin e sovranitetit dhe të integritetit territorial të shteteve.

Neni 6 – Informimi

Palët marrin përsipër që të kujdesen që autoritetet, organizatat dhe personat e interesuar informohen lidhur me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë Kartë.

Pjesa II – Objektivat dhe parimet e ndjekura në pajtim me nenin 2, paragrafin 1

Neni 7 – Objektivat dhe parimet

1. Lidhur me gjuhët rajonale ose të pakicës, brenda territoreve në të cilat përdoren këto gjuhë dhe në pajtim me gjendjen e secilës gjuhë, palët i bazojnë politikën, legjislacionin dhe praktikën e tyre në objektivat dhe parimet në vijim:
 - a. në pranimin e gjuhëve rajonale ose të pakicës si shprehje e pasurisë kulturore;
 - b. në respekimin e zonës gjeografike të secilës gjuhë rajonale ose të pakicës në mënyrë që të sigurojë që ndarjet administrative ekzistuese ose të reja nuk paraqesin pengesë për përkrahjen e gjuhës së përmendur rajonale ose të pakicës;
 - c. në nevojën për veprim të vendosur për përkrahjen e gjuhëve rajonale ose të pakicës në mënyrë që t'i ruaj ato;
 - d. në lehtësimin dhe /ose inkurajimin e përdorimit të gjuhëve rajonale ose të pakicës, në të folur dhe të shkruar, në jetën publike dhe atë private;
 - e. në mbajtjen dhe krijimin e lidhjeve, në fushat e përfshira në këtë Kartë, ndërmjet grupeve që e përdorin një gjuhë rajonale ose të pakicës dhe të grupeve të tjera në këtë shtet që e flasin një gjuhë të përdorur në formë të njëjtë ose të ngjashme, si edhe në vendosjen e marrëdhënieve kulturore me grupet e tjera në shtet të cilat përdorin gjuhë të ndryshme;
 - f. në sigurimin e formave dhe të mjeteve të përshtatshme për mësimin dhe studimin e gjuhëve rajonale ose të pakicës në të gjitha nivelet e përshtatshme;
 - g. në sigurimin e lehtësive që ju japin mundësi personave që nuk e flasin një gjuhë rajonale ose të pakicës, të cilët jetojnë në zonën ku ajo gjuhë përdoret, ta mësojnë atë nëse dëshirojnë;
 - h. në përkrahjen e studimit dhe të kërkimit mbi gjuhët rajonale ose të pakicës në universitete ose në institucionet e barasvlershme;
 - i. në përkrahjen e formave të përshtatshme të shkëmbimeve ndërkombëtare, në fushat e përfshira në këtë Kartë, për gjuhët rajonale ose të pakicës të përdorura në formë të njëjtë ose të ngjashme në dy ose më shumë shtete.

2. Palët, nëse nuk e kanë bërë këtë akoma, angazhohen ta mënjanojnë çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë të pajustificueshme që ka të bëjë me përdorimin e gjuhës rajonale ose të pakicës dhe që ka për qëllim ta shkurajojë ose rrezikojë ruajtjen ose zhvillimin e saj. Miratimi i masave të posaçme në favor të gjuhëve rajonale ose të pakicës që synojnë ta përkrahin barazinë ndërmjet folësve të këtyre gjuhëve dhe të pjesës tjetër të popullsisë, ose të cilat duke marrë parasysh kushtet e tyre të

veçanta nuk konsiderohen si akt i diskriminimit të folësve të gjuhëve të përdorura më shumë.

3. Palët angazhohen të përkrahin, nëpërmjet masave të përshtatshme, mirëkuptimin e ndërsjellë ndërmjet të gjitha grupeve gjuhësore të vendit dhe në veçanti përfshirjen e respektit, të mirëkuptimit dhe të tolerancës lidhur me gjuhët rajonale dhe të pakicës në mesin e objektivave të arsimit dhe të aftësisë, të ofruara në vendet e tyre, dhe të inkurajimit të mjeteve të komunikimit masiv për ndjekjen e objektivit të njëjtë.
4. Për ta bërë përcaktimin e politikës së tyre lidhur me gjuhët rajonale ose të pakicës, palët i marrin parasysh nevojat dhe dëshirat e shprehura nga grupet të cilat i përdorin ato gjuhë. Ato inkurajohen që, nëse është e nevojshme, të krijojnë organe me qëllim të këshillimit të autoriteteve për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me gjuhët rajonale ose të pakicës.
5. Palët angazhohen t'i zbatojnë, *me ndryshimet e nevojshme*, parimet e parashtruara në paragrafet 1 deri 4 më sipër për gjuhët jo-territoriale. Megjithatë, për sa ju përket këtyre gjuhëve, natyra dhe tërësia e masave që duhet të merren për ta zbatuar këtë Kartë përcaktohen në mënyrë fleksibile, duke i pasur parasysh nevojat dhe dëshirat, dhe duke i respektuar traditat dhe karakteristikat, e grupeve të cilat i shfrytëzojnë këto gjuhë.

Pjesa III – Masat për përkrahjen e përdorimit të gjuhëve rajonale ose të pakicës në jetën publike, në përputhje me angazhimet e përcaktuara në nenin 2, paragrafi 2

Neni 8 – Arsimi

1. Lidhur me arsimin, në territorin ku përdoren këto gjuhë, varësisht nga gjendja e secilës prej këtyre gjuhëve dhe pa e dëmtuar mësimin e gjuhës (gjuhëve) zyrtare të shtetit, palët angazhohen:
 - a.
 - i. ta bëjnë të mundur arsimin parashkollor në gjuhët përkatëse rajonale ose të pakicës; ose
 - ii. ta bëjnë të mundur një pjesë të konsiderueshme të arsimit parashkollor në gjuhët përkatëse rajonale ose të pakicës; ose
 - iii. ta zbatojnë njërën nga masat e parashikuara nën i dhe ii më sipër, së paku për ata nxënës familjet e të cilëve e kërkojnë këtë dhe numri i të cilëve konsiderohet të jetë i mjaftueshëm; ose
 - iv. nëse autoritetet publike nuk kanë kompetencë të drejtëpërdrejtë në fushën e arsimit parashkollor, të favorizojnë dhe/ose të inkurajojnë zbatimin e masave të përmendura prej i deri në iii më sipër;
 - b.

- i. ta bëjnë të mundur arsimin fillor në gjuhët përkatëse rajonale ose të pakicës; ose
 - ii. ta bëjnë të mundur një pjesë të konsiderueshme të arsimit fillor në gjuhët përkatëse rajonale ose të pakicës; ose
 - iii. të sigurojnë, në kuadër të arsimit fillor, mësimin e gjuhëve përkatëse rajonale ose të pakicës si pjesë përbërëse të programit mësimor; ose
 - iv. ta zbatojnë ndonjëherë prej masave të parashikuara prej i deri iii më sipër, së paku për ata nxënës familjet e të cilëve e kërkojnë këtë dhe numri i të cilëve konsiderohet si i mjaftueshëm;
- c.
- i. ta mundësojnë arsimin e mesëm në gjuhët përkatëse rajonale ose të pakicës; ose
 - ii. ta mundësojnë një pjesë të konsiderueshme të arsimit të mesëm në gjuhët përkatëse rajonale ose të pakicës; ose
 - iii. të sigurojnë, në kuadër të arsimit të mesëm, mësimin e gjuhëve përkatëse rajonale ose të pakicës si pjesë përbërëse e programit mësimor; ose
 - iv. ta zbatojnë ndonjëherë prej masave të parashikuara prej i deri iii më sipër, së paku për ata nxënës, ose sipas nevojës, familjet e të cilëve e dëshirojnë këtë dhe janë në numër të mjaftueshëm;
- d.
- i. ta bëjnë të mundur arsimin teknik dhe profesional në gjuhët përkatëse rajonale ose të pakicës; ose
 - ii. të sigurojnë, në kuadër të arsimit teknik dhe profesional, mësimin e gjuhëve përkatëse rajonale ose të pakicës si pjesë përbërëse e programeve mësimore; ose
 - iii. ta zbatojnë njëherë prej masave të parashikuara prej i deri iii, së paku për ata nxënës, ose sipas nevojës, familjet e të cilëve e dëshirojnë këtë dhe janë në numër të mjaftueshëm;
- e.
- i. ta bëjnë të mundur arsimin universitar dhe arsimin tjetër të lartë në gjuhët përkatëse rajonale ose të pakicës; ose
 - ii. të ofrojnë mundësi për studimin e këtyre gjuhëve si lëndë universitare dhe të shkollimit të lartë; ose
 - iii. në rast se, për arsye të rolit të shtetit lidhur me institucionet e arsimit të lartë, nuk mund të zbatohen nënparagrafët i dhe ii, të inkurajojnë dhe/ose të lejojnë sigurimin e universitetit ose të formave të tjera të arsimit të lartë në gjuhët rajonale ose të pakicës ose të lehtësive për studimin e këtyre gjuhëve si lëndë universitare ose të arsimit të lartë;
- f.
- i. ta garantojnë ofrimin e kurseve për të rritur dhe të kurseve të vazhdueshme arsimore në të cilat mësohet kryesisht ose tërësisht në gjuhët rajonale ose të pakicës; ose
 - ii. t'i ofrojnë gjuhët e tilla si lëndë të arsimit të të rriturve ose të vazhdueshëm; ose

- iii. nëse autoritetet publike nuk kanë kompetencë të drejtpërdrejtë në fushën e arsimit për të rritur, të favorizojnë dhe/ose të inkurajojnë ofrimin e gjuhëve të tilla si lëndë të arsimit për të rritur dhe të atij të vazhdueshëm;
 - g. të marrin masa për të siguruar të mësuarit e historisë dhe të kulturës e cila pasqyrohet nga gjuha rajonale ose e pakicës;
 - h. të ofrojnë aftësim themelor dhe të mëtejshëm të mësimdhënësve i cili nevojitet për zbatimin e atyre të paragrafëve a deri g të pranuar nga pala;
 - i. ta krijojnë një organ ose organe mbikëqyrëse përgjegjëse për mbikëqyrjen e masave të marra dhe të përparimit të arritur në vendosjen ose në zhvillimin e mësimin të gjuhëve rajonale ose të pakicës dhe për hartimin e raporteve të herëpashershme të rezultateve të tyre, të cilat do të bëhen publike.
2. Lidhur me arsimin dhe me territoret përveç atyre në të cilat gjuhët rajonale ose të pakicës përdoren në mënyrë tradicionale, nëse numri i folësve të gjuhës rajonale ose të pakicës e justifikon këtë, palët angazhohen ta lejojnë, ta inkurajojnë ose ta ofrojnë mësimin dhe mësimdhënien në gjuhët rajonale ose të pakicës në të gjitha nivelet e përshtatshme të arsimit.

Neni 9 – Autoritetet gjyqësore

1. Palët angazhohen që, në ato zona gjyqësore në të cilat numri i banorëve që i përdorin gjuhët rajonale ose të pakicës i justifikon masat e saktësuara më poshtë, sipas gjendjes së secilës prej këtyre gjuhëve dhe me kusht që lehtësitë e ofruara me këtë paragraf të mos konsiderohen nga gjykatësi si pengesë për administrimin e duhur të drejtësisë:
- a. në procedurën penale:
 - i. të sigurojnë që gjykatat, me kërkesë të njërës prej palëve, t'i zhvillojnë procedurat gjyqësore në gjuhët rajonale ose të pakicës; dhe/ose
 - ii. t'ia garantojnë të akuzuarit të drejtën për përdorimin e gjuhës së tij rajonale ose të pakicës; dhe/ose
 - iii. të sigurojnë që kërkesat dhe provat, pavarësisht a janë në formë të shkruar apo me gojë, nuk konsiderohen të papranueshme vetëm pse janë të formuluar në gjuhë rajonale ose të pakicës; dhe/ose
 - iv. kur kërkohet, t'i paraqesin dokumentet që kanë të bëjnë me procedurat gjyqësore në gjuhën përkatëse rajonale ose të pakicës,

nëse është e nevojshme duke i shfrytëzuar përkthyesit dhe përkthimet pa shkaktuar shpenzime shtesë për personat e përmendur;

- b. në procedurën civile:
 - i. të sigurojnë që gjykatat, me kërkesë të njërës prej palëve, i zhvillojnë procedurat gjyqësore në gjuhët rajonale ose të pakicës; dhe/ose
 - ii. të lejojnë, kurdoherë që një palë në kontest duhet të paraqitet personalisht në gjyq, që ai ose ajo ta

përdorë gjuhën e tij ose të saj rajonale ose të pakicës pa shkaktuar në këtë mënyrë shpenzime shtesë; dhe/ose

- iii. ta lejojnë paraqitjen e dokumenteve dhe të provave në gjuhët rajonale ose të pakicës,

nëse është e nevojshme duke i shfrytëzuar përkthyesit dhe përkthimet;

- c. në procedurat gjyqësore lidhur me çështjet administrative:

- i. të sigurojnë që gjykatat, me kërkesë të njëjës prej palëve, i zhvillojnë procedurat në gjuhët rajonale ose të pakicës; dhe/ose
- ii. të lejojnë, kurdoherë që një palë në kontest duhet të paraqitet personalisht në gjyq, që ai ose ajo ta përdorë gjuhën e tij ose të saj rajonale ose të pakicës pa shkaktuar në këtë mënyrë shpenzime shtesë; dhe/ose
- iii. ta lejojnë paraqitjen e dokumenteve dhe të provave në gjuhët rajonale ose të pakicës,

nëse është e domosdoshme duke i shfrytëzuar përkthyesit dhe përkthimet;

- d. të marrin masa për t'u siguruar që zbatimi i nënparagrafëve i dhe iii të paragrafëve b dhe c më sipër dhe ndonjë shfrytëzim i domosdoshëm i përkthyesve dhe përkthimeve nuk shkakton shpenzime shtesë për ata persona.

- 2. Palët angazhohen:

- a. të mos e mohojnë vlefshmërinë e dokumenteve juridike të hartuara në shtet vetëm për arsye se ato janë hartuar në gjuhën rajonale ose të pakicës; ose
- b. të mos e mohojnë vlefshmërinë, ndërmjet palëve, të dokumenteve juridike të hartuara në shtet vetëm për arsye se janë hartuar në gjuhën rajonale ose të pakicës, dhe të sigurojnë se ato mund të përdoren kundër palëve të treta të interesuara të cilët nuk janë folës të këtyre gjuhëve, me kusht që përmbajtja e dokumentit t'iu bëhet e njohur atyre nga personi (personat) i cili e përdorë atë; ose
- c. të mos e mohojë vlefshmërinë, ndërmjet palëve, të dokumenteve juridike të hartuara brenda vendit vetëm për arsye se janë hartuar në një gjuhë rajonale ose të pakicës.

- 3. Palët angazhohen të sigurojnë botimin e teksteve më të rëndësishme kombëtare të parashikuara me statut dhe të atyre që kanë të bëjnë në veçanti me folësit e këtyre gjuhëve në gjuhët rajonale ose të pakicës, përveç nëse parashihet ndryshe.

Neni 10 – Autoritetet administrative dhe shërbimet publike

- 1. Në zonat administrative të shtetit, në të cilin numri i banorëve të cilët janë folës të gjuhëve rajonale ose të pakicës i justifikon masat e saktësuara në vijim, dhe varësisht nga gjendja e secilës gjuhë, palët angazhohen, për aq sa është e mundur:

- a.
 - i. të sigurojnë që autoritetet administrative i përdorin gjuhët rajonale ose të pakicës; ose

- ii. të sigurojnë që zyrtarët e tyre të cilët kanë kontakt me publikun i përdorin gjuhët rajonale ose të pakicës në marrëdhëniet e tyre me personat të cilët ju drejtohen atyre në këto gjuhë; ose
 - iii. të sigurojnë që folësit e gjuhëve rajonale ose të pakicës mund të dorëzojnë kërkesa me gojë ose me shkrim dhe të marrin përgjigje në këto gjuhë; ose
 - iv. të sigurojnë që folësit e gjuhëve rajonale ose të pakicës mund të dorëzojnë kërkesa me gojë ose me shkrim në këto gjuhë; ose
 - v. të sigurojnë që folësit e gjuhëve rajonale ose të pakicës mund ta dorëzojnë në mënyrë të vlefshme një dokument në këto gjuhë;
 - b. të vënë në dispozicion në gjuhë rajonale ose të pakicës ose në dy gjuhë tekstet dhe formularët administrativ që më së shumti përdoren;
 - c. t'i lejojnë autoritetet administrative të hartojnë dokumente në gjuhë rajonale ose të pakicës.
2. Lidhur me autoritetet lokale dhe rajonale në territorin e të cilave numri i banorëve që i flasin gjuhët rajonale ose të pakicës i justifikon masat e saktësuara më poshtë, palët angazhohen ta lejojnë dhe/ose ta inkurajojnë:
- a. përdorimin e gjuhëve rajonale ose të pakicës brenda kornizës së autoritetit rajonal ose lokal;
 - b. mundësinë që folësit e gjuhëve rajonale ose të pakicës të dorëzojnë kërkesa me gojë ose me shkrim në këto gjuhë;
 - c. publikimin nga ana e autoriteteve rajonale të dokumenteve të tyre zyrtare poashtu në gjuhët përkatëse rajonale ose të pakicës;
 - d. publikimin nga ana e autoriteteve lokale të dokumenteve të tyre zyrtare poashtu në gjuhët përkatëse rajonale ose të pakicës;
 - e. përdorimin nga ana e autoriteteve rajonale të gjuhëve rajonale ose të pakicës në debatet në kuvendet e tyre, pa e përjashtuar, megjithatë, përdorimin e gjuhës (të gjuhëve) zyrtare të shtetit;
 - f. përdorimin nga ana e autoriteteve lokale të gjuhëve rajonale ose të pakicës në debatet në kuvendet e tyre, pa e përjashtuar, megjithatë, përdorimin e gjuhës (të gjuhëve) zyrtare në shtet;
 - g. përdorimin ose miratimin, nëse është e domosdoshme në lidhje me emrin në gjuhën (gjuhët) zyrtare, të formave tradicionale dhe të rregullta të emrave të vendeve në gjuhët rajonale ose të pakicës;
3. Lidhur me shërbimet publike të ofruara nga autoritetet administrative ose nga personat e tjerë që veprojnë në emër të tyre, palët ndërmarrin, brenda territorit në të cilin përdoren gjuhët rajonale ose të pakicës, varësisht nga gjendja e secilës gjuhë dhe në qoftë se kjo është e mundur:
- a. të sigurojnë që gjuhët rajonale ose të pakicës përdoren gjatë ofrimit të shërbimeve; ose
 - b. t'i lejojnë folësit e gjuhëve rajonale ose të pakicës të dorëzojnë kërkesë dhe të marrin përgjigje në këto gjuhë; ose
 - c. t'i lejojnë folësit e gjuhëve rajonale ose të pakicës të dorëzojnë kërkesë në këto gjuhë.

4. Me qëllim të zbatimit të dispozitave të paragrafëve 1, 2 dhe 3 të pranuar nga ato, palët angazhohen të ndërmarrin një apo më shumë prej masave në vijim:
 - a. përkthimin sipas nevojës;
 - b. punësimin dhe, sipas nevojës, aftësimin e zyrtarëve dhe të të punonjësve të tjerë të shërbimit publik që kërkohet;
 - c. përputhjen për aq sa është e mundur me kërkesat që punonjësit e shërbimeve publike të cilët i njohin gjuhët rajonale ose të pakicës të emërohen në territorin ku përdoret ajo gjuhë.
5. Palët angazhohen ta lejojnë përdorimin ose miratimin e mbiemrave në gjuhët rajonale ose të pakicës, me kërkesë të atyre personave.

Neni 11 – Mjetet e komunikimit

1. Palët angazhohen, për folësit e gjuhëve rajonale ose të pakicës brenda territorit ku fliten ato gjuhë, varësisht nga gjendja e secilës gjuhë, dhe në masën që autoritetet publike, drejtpërdrejt ose tërthorazi, janë kompetente, kanë kompetenca ose luajnë rol në këtë fushë, dhe duke e respektuar parimin e pavarësisë dhe të autonomisë të mjeteve të komunikimit:
 - a. në shkallën që radioja dhe televizioni kryejnë mision të shërbimit publik:
 - i. të sigurojnë hapjen e së paku një radio stacioni dhe të një kanali televiziv në gjuhët rajonale ose të pakicës; ose
 - ii. ta inkurajojnë dhe/ose ndihmojnë krijimin e së paku një radio stacioni dhe të një kanali televiziv në gjuhët rajonale ose të pakicës; ose
 - iii. të marrin masa të përshtatshme në mënyrë që transmetuesit të ofrojnë programe në gjuhët rajonale ose të pakicës;
 - b.
 - i. të inkurajojnë dhe/ose ta ndihmojnë krijimin e së paku një radio stacioni në gjuhët rajonale ose të pakicës; ose
 - ii. të inkurajojnë dhe/ose ta ndihmojnë transmetimin rregullt të programeve të radios në gjuhët rajonale ose të pakicës;
 - c.
 - i. të inkurajojnë dhe/ose ta ndihmojnë krijimin e së paku një kanali televiziv në gjuhët rajonale ose të pakicës; ose
 - ii. të inkurajojnë dhe/ose ta ndihmojnë transmetimin e rregullt të programeve televizive në gjuhët rajonale ose të pakicës;
 - d. të inkurajojnë dhe/ose ta ndihmojnë incizimin dhe shpërndarjen e punës audiovizuale në gjuhët rajonale ose të pakicës;
 - e.
 - i. të inkurajojnë dhe/ose ta ndihmojnë krijimin dhe/ose mbajtjen e së paku një gazeteje në gjuhët rajonale ose të pakicës; ose
 - ii. të inkurajojnë dhe/ose ta ndihmojnë publikimin e rregullt të artikujve të gazetës në gjuhët rajonale ose të pakicës;
 - f.

- i. t'i mbulojnë shpenzimet shtesë të atyre mjeteve të komunikimit të cilat i shfrytëzojnë gjuhët rajonale ose të pakicës, kudo që ligji parasheh ndihmë financiare në përgjithësi për mjetet e komunikimit; ose
 - ii. t'i zbatojnë masat ekzistuese për ndihmë financiare poashtu për xhirimet audiovizuale në gjuhët rajonale ose të pakicës;
 - g. të përkrahin aftësimin e gazetarëve dhe të personelit tjetër të mjeteve të komunikimit që i përdorin gjuhët rajonale dhe të pakicës.
- 2. Palët angazhohen ta garantojnë lirinë e marrjes së drejtpërdrejtë të emisioneve të radios dhe të televizionit nga vendet fqinje në gjuhën që përdoret në formë të njëjtë ose të ngjashem me gjuhën rajonale ose të pakicës, dhe të mos e kundërshtojnë ritransmetimin e emisioneve të radios dhe të televizionit nga vendet fqinje në gjuhën e tillë. Ato më tej angazhohen të sigurojnë që nuk do të ketë kufizime lidhur me lirinë e të shprehurit dhe qarkullimin e lirë të informatave në shtyp në gjuhën që ka formë të njëjtë ose të ngjashme me gjuhën rajonale ose të pakicës. Ushtrimi i lirive të lartpërmendura, pasi që mbajnë në vete obligime dhe përgjegjësi, mund t'i nënshtrohet formaliteteve, kushteve, kufizimeve dhe ndëshkimeve të tilla ashtu si parashikohen me ligj dhe që janë të domosdoshme në shoqërinë demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, të integritetit territorial ose të sigurisë publike, për parandalimin e trazirave ose të krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e reputacionit ose të të drejtave të të tjerëve, për parandalimin e zbulimit të informatave të marra në mirëbesim, ose për mbajtjen e autoritetit dhe të paanshmërisë të gjyqësorit.
- 3. Palët angazhohen të sigurojnë përfaqësimin apo marrjen parasysh të interesave të folësve të gjuhëve rajonale ose të pakicës brenda organeve të tilla që mund të themelohen sipas ligjit, të cilat kanë përgjegjësi ta garantojnë lirinë dhe pluralizmin në mjetet e komunikimit.

Neni 12 – Aktivitetet dhe objektet kulturore

1. Lidhur me aktivitetet dhe objektet kulturore – sidomos bibliotekat, video bibliotekat, qendrat kulturore, muzeumet, arkivat, akademitë, teatrot dhe kinematë, si edhe veprat letrare dhe produksionet filmike, format amëtare të shprehjes kulturore, festivalet dhe industritë kulturore, duke e përfshirë *ndërmjet të tjerave*, përdorimin e teknologjive të reja – palët angazhohen, brenda territorit në të cilin fliten gjuhët e tilla dhe deri në shkallën në të cilën autoritetet publike janë kompetente, kanë pushtet ose luajnë rol në këtë fushë:
 - a. të inkurajojnë llojet e shprehjes dhe të nismave që janë specifike për gjuhët rajonale ose të pakicës dhe të nxisin mjetet e ndryshme të qasjes në veprat e punuara në këto gjuhë;
 - b. të nxisin mjetet e ndryshme të qasjes së gjuhëve të tjera në veprat e punuara në gjuhët rajonale ose të pakicës duke e ndihmuar dhe zhvilluar përkthimin, dublimin, pas-sinkronizimin dhe aktivitetet e titimit;
 - c. të nxisin qasjen e gjuhëve rajonale ose të pakicës në veprat e punuara në gjuhët e tjera duke e ndihmuar dhe zhvilluar

- përkthimin, dublimin, pas-sinkronizimin dhe aktivitetet e titrimit;
- d. të sigurojnë që organet përgjegjëse për organizimin dhe mbështetjen e aktiviteteve kulturore të llojeve të ndryshme japin ndihmë të duhur financiare për përfshirjen e njohurisë dhe të përdorimit të gjuhëve dhe kulturës të pakicave në aktivitetet të cilat i fillojnë ose për të cilat ofrojnë mbështetje;
 - e. t'i përkrahin masat për të siguruar që organet të cilat janë përgjegjëse për organizimin ose mbështetjen e aktiviteteve kulturore kanë në disponim personel që kanë njohuri të plotë të asaj gjuhe rajonale ose të pakicës, si edhe të gjuhës (-ve) të pjesës tjetër të popullsisë;
 - f. ta inkurajojnë pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të përfaqësuesve të folësve të gjuhës së caktuar rajonale ose të pakicës duke i siguruar objektet dhe duke planifikuar aktivitete kulturore;
 - g. ta inkurajojnë dhe/ose ta ndihmojnë krijimin e një organi ose të disa organeve përgjegjëse për mbledhjen, mbajtjen e një kopjeje të veprave ose prezantimin dhe botimin e veprave të punuara në gjuhët rajonale ose të pakicës;
 - h. nëse është e nevojshme, t'i krijojnë dhe/ose t'i përkrahin dhe financojnë shërbimet e përkthimit dhe të kërkimit të terminologjisë, sidomos me qëllim të ruajtjes dhe të zhvillimit të terminologjisë së duhur administrative, komerciale, ekonomike, sociale, teknike ose juridike në secilën gjuhë rajonale ose të pakicës.
2. Lidhur me territoret e tjera nga ato në të cilat përdoren gjuhët rajonale ose të pakicës në mënyrë tradicionale, nëse numri i folësve të gjuhës rajonale apo të pakicës e justifikon këtë, palët angazhohen të lejojnë, të inkurajojnë dhe/ose të ofrojnë aktivitete dhe objekte të përshtatshme kulturore në pajtim me paragrafin paraprak.
 3. Palët angazhohen të marrin masa të duhura, gjatë ndjekjes së politikës së tyre kulturore jasht vendit, për gjuhët rajonale ose të pakicës dhe të kulturës që e pasqyrojnë ato.

Neni 13 – Jeta ekonomike dhe shoqërore

1. Lidhur me aktivitetet ekonomike dhe kulturore, palët angazhohen, në tërë vendin:
 - a. ta mënjanojnë nga legjislacioni i tyre çdo dispozitë me të cilën ndalohet ose kufizohet pa arsye të përligjshme përdorimi i gjuhëve rajonale ose të pakicës në dokumentet që kanë të bëjnë me jetën ekonomike ose shoqërore, sidomos në kontratat e punësimit, dhe në dokumentet teknike siç janë udhëzimet për përdorimin e prodhimeve ose të pajisjeve;
 - b. ta ndalojnë përfshirjen në rregulloret e brendshme të kompanive dhe në dokumentet private të ndonjë neni i cili e përjashton ose e kufizon përdorimin e gjuhëve rajonale ose të pakicës, së paku ndërmjet folësve të gjuhës së njëjtë;
 - c. t'i kundërshtojnë praktikën e hartuara për shkurajimin e përdorimit të gjuhëve rajonale ose të pakicës lidhur me aktivitetet ekonomike ose shoqërore;

- d. ta lehtësojnë dhe/ose ta inkurajojnë përdorimin e gjuhëve rajonale ose të pakicës me mjete të tjera prej atyre të saktësuara në nënparagrafët e mësipërm.
2. Lidhur me aktivitetet ekonomike dhe shoqërore, palët angazhohen, në shkallën që autoritetet publike janë kompetente, brenda territorit në të cilin fliten gjuhët rajonale ose të pakicës, dhe përderisa kjo është në mënyrë të arsyeshme e mundur:
 - a. të përfshijnë në rregulloret e tyre financiare dhe bankare dispozita të cilat e lejojnë, me anë të procedurave të pajtueshme me praktikat komerciale, përdorimin e gjuhëve rajonale dhe të pakicës gjatë hartimit të urdhëresave për pagesë (të çeqeve, urdhërpagesave, etj.) ose të dokumenteve të tjera financiare ose, sipas nevojës, ta sigurojnë zbatimin e dispozitave të tilla;
 - b. në sektoret ekonomike dhe shoqërore të cilat janë drejtpërdrejt në kontrollin e tyre (sektori publik), të organizojnë aktivitete për përkrahjen e përdorimit të gjuhëve rajonale ose të pakicës;
 - c. të përkujdesen që objektet për përkujdesje shoqërore siç janë spitalet, shtëpitë e pleqve dhe azilet ofrojnë mundësi të pranimit dhe të trajtimit në gjuhën e tyre personat që e përdorin gjuhën rajonale ose të pakicës dhe të cilët kanë nevojë për shkak të shëndetit të ligë, moshës së vjetër ose për arsye të tjera;
 - d. të sigurojnë përmes mjeteve të përshtatshme që udhëzimet për sigurinë të hartohen poashtu edhe në gjuhët rajonale ose të pakicës;
 - e. të përkujdesen që informatat e ofruara nga autoritetet publike kompetente lidhur me të drejtat e konsumatorëve të jenë në dispozicion në gjuhët rajonale dhe të pakicës.

Neni 14 – Shkëmbimet ndërkufitare

Palët angazhohen:

- a. t'i zbatojnë marrëveshjet ekzistuese dypalëshe dhe shumëpalëshe të cilat i lidhin ato me shtetet në të cilat përdoret gjuha e njëjtë në formë të njëjtë apo të ngjashme, ose nëse është e nevojshme të kërkojnë të arrijnë marrëveshje të tilla, në atë mënyrë që t'i nxisin kontaktet ndërmjet folësve të gjuhës së njëjtë në shtetet në fjalë në fushën e kulturës, të arsimit, informimit, aftësimin profesional dhe arsimit të përhershëm;
- b. për interes të gjuhëve rajonale ose të pakicës, ta ndihmojnë dhe/ose ta përkrahin bashkëpunimin përtej kufirit, në veçanti ndërmjet autoriteteve rajonale dhe lokale në territorin e të cilave përdoret gjuha e njëjtë në formë të njëjtë ose të ngjashme.

Pjesa IV – Zbatimi i Kartës

Neni 15 – Raportet periodike

1. Palët i paraqesin herëpashërë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, në mënyrën e parashkruar nga komiteti i ministrave, një raport për politikën e tyre që e kanë ndjekur në pajtim me Pjesën II të kësaj Karte dhe për masat që janë marrë për zbatimin e atyre dispozitave të Pjesës III të cilat i kanë pranuar. Raporti i

parë paraqitet brenda vitit pas hyrjes në fuqi të Kartës lidhur me palët e përmendura, raportet e tjera në intervale tri-vjeçare pas raportit të parë.

2. Palët i bëjnë raportet e tyre publike.

Nei 16 – Shqyrtimi i raporteve

1. Raportet të cilat i paraqiten Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës sipas nenit 15 shqyrtohen nga komisioni i ekspertëve që themelohet në pajtim me nenin 17.
2. Organet ose shoqatat e themeluara në mënyrë të ligjshme në një palë mund ta tërheqin vëmendjen e komisionit të ekspertëve lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me angazhimet e bëra nga ajo palë sipas Pjesës III të kësaj Karte. Pas këshillimit me palën në fjalë, komisioni i ekspertëve mund ta marrë parasysh këtë informatë gjatë përgatitjes së raportit të saktësuar në paragrafin 3 në vijim. Këto organe ose shoqata veç kësaj mund të dorëzojnë deklaratata lidhur me politikën e ndjekur nga pala në pajtim me Pjesën II.
3. Në bazë të raporteve të saktësuar në paragrafin 1 dhe të informatave të përmendura në paragrafin 2, komisioni i ekspertëve e përgatit një raport për komitetin e ministrave. Ky raport shoqërohet nga komentet të cilat janë kërkuar të bëhen nga palët dhe mund të bëhet publik nga komiteti i ministrave.
4. Raporti i saktësuar në paragrafin 3 i përmban në veçanti propozimet e komisionit të ekspertëve për komitetin e ministrave për përgatitjen e rekomandimeve të tilla të këtij të fundit për një ose më shumë palë sipas nevojës.
5. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës e paraqet një raport të hollësishëm dyvjeçar në Asamblenë Parlamentare lidhur me zbatimin e Kartës.

Neni 17 – Komisioni i ekspertëve

1. Komisioni i ekspertëve përbëhet nga një anëtarë i secilës palë, të emëruar nga komiteti i ministrave nga lista e individëve të cilët kanë integritet të lartë dhe zotësi të pranuar në çështjet me të cilat merret Karta, të cilët propozohen nga pala në fjalë.
2. Anëtarët e komisionit emërohen për një periudhë gjashtë vjeçare dhe kanë të drejtë të emërohen sërish. Anëtari i cili nuk mund ta kryejë detyrën zëvendësohet në pajtim me procedurën e parashtruar në paragrafin 1, dhe anëtari që e zëvendëson atë e kryen detyrën e pararendësit të tij.
3. Komisioni i ekspertëve e miraton rregulloren e punës. Shërbimet e sekretarisë ofrohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.

Pjesa V – Dispozitat përfundimtare

Neni 18

Kjo Kartë është e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Ajo i nënshtrohet ratifikimit, pranimit apo miratimit. Instrumentet e ratifikimit, të pranimit apo të miratimit depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.

Neni 19

1. Kjo Kartë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pasues pas skadimit të periudhës prej tre muajve pas datës në të cilën pesë shtete anëtare të Këshillit të Evropës e kanë shprehur pajtimin e tyre që të obligohen nga Karta në pajtim me dispozitat e nenit 18.
2. Sa i përket ndonjë shteti anëtar që më pas e shprehë pëlqimin të obligohet nga kjo, Karta hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pasues pas skadimit të periudhës tremujore pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, të pranimit ose të miratimit.

Neni 20

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Karteje, komiteti i ministrave i Këshillit të Evropës mund ta ftojë cilindo shtet që nuk është anëtar i Këshillit të Evropës ta miratojë këtë Kartë.
2. Lidhur me cilindo shtet që e miraton atë, Karta hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pasues pas skadimit të periudhës tremujore pas datës së depozitimit të instrumentit të hyrjes tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.

Neni 21

1. Çdo Shtet, në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të hyrjes, mund të shprehë një apo më shumë rezerva lidhur me paragrafët 2 deri 5 të nenit 7 të kësaj Karte. Asnjë rezervë tjetër nuk mund të shprehet.
2. Çdo shtet kontraktues i cili ka shprehë rezerva sipas paragrafit pararendës mund ta tërheq atë tërësisht apo pjesërisht me anë të një njoftimi të cilin ia drejton Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Tërheqja hyn në fuqi atë ditë kur Sekretari i Përgjithshëm e pranon një njoftim të tillë.

Neni 22

1. Çdo palë mundet në çdo kohë ta shpallë të pavlefshme këtë Kartë përmes një njoftimit të drejtuar te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.
2. Shpallja e tillë e pavlefshme hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që vjen pas skadimit të periudhës gjashtëmujore pas datës së pranimit të njoftimit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 23

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës i njofton shtetet anëtare të Këshillit dhe çdo shtet i cili e ka miratuar këtë Kartë lidhur me:

- a. çdo nënshkrim;
- b. depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të hyrjes;
- c. çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Karte në pajtim me nenit 19 dhe 20;
- d. çdo njoftim të pranuar në zbatim të dispozitave të nenit 3, paragrafit 2;
- e. ndonjë akt, njoftim apo komunikatë tjetër lidhur me këtë Kartë.

Në dëshmi të saj nënshkruarit, të autorizuar sipas rregullit për këtë, e kanë nënshkruar këtë Kartë.

Përfunduar në Strazbur, me 5 nëntor 1992, në gjuhën angleze dhe franceze, ku të dy tekstet kanë vlerë të njëjtë, dhe nga një kopje në secilën gjuhë depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës ua dërgon kopjet e certifikuara secilit shtet anëtar të Këshillit të Evropës dhe çdo shteti të ftuar ta miratojë këtë Kartë.